

**AKT THEMELUES**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“EURO JOB” SHPK**

Sot me datë **05/02/2025**(Dy mijë e njëzet e pesë), unë **Elvis Bilal Sherifi**, i datëlindjes 04.11.2001, lindur në Bërzhitë dhe banues në Ibë e Poshtme, Bërzhitë, Tiranë, banese private, identifikuar me Letërnjoftim ID me nr.Personal K11104018P, Ortak i vetëm i shoqërisë **“Euro Job” Sh.p.k.**, mbështetur në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” krijoj Shoqërinë më përgjegjësi të kufizuar **“Euro Job” Sh.p.k.**, me aktin themelues të saj si vijon:

**F O R M I M I**

**NENI 1**

Formohet Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“Euro Job” Sh.p.k.**, me ortak të vetëm **Elvis Sherifi**, i datëlindjes 04.11.2001, lindur në Bërzhitë dhe banues në Ibë e Poshtme, Bërzhitë, Tiranë, banese private, identifikuar me Letërnjoftim ID me nr.Personal K11104018P.

Shoqëria **“Euro Job” sh.p.k** është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”). Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

**SELIA E SHOQËRISË**

**NENI 2**

Shoqëria e ka selinë në adresën Rruga “Frederik Shiroka”, Njësia Bashkiake nr.7, Pallati nr.5, katë i 2-të, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nëpermjet vendimit vetëm nga Administratori si edhe të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

**NENI 3**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e:

- *Shërbime konsulencë juridike ndërkombëtare dhe kombëtare për individë, kompani dhe organizata, përfshirë këshillim dhe asistencë ligjore në çështje civile, tregtare, të drejtat e njeriut, dhe çështje administrative. Shërbimet përfshijnë: hartimin dhe shqyrtimin e kontratave ndërkombëtare dhe kombëtare, këshillim për rregullore dhe ligje ndërkombëtare dhe kombëtare që lidhen me investimet, biznesin dhe tregtinë.*



-Shërbime për regjistrimin e kompanive, asistencë ligjore në migracion dhe leje qëndrimi, si dhe konsulencë tekniko-ligjore në projekte ndërkombëtare dhe lokale.

-Shërbime të konsulencës në fushën e punës, brenda dhe jashtë vendit për individë, kompani si dhe çdo veprimtare tjeter ekonomike që të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimeve të biznesit e që nuk bie ndesh me legjisacionin në fuqi.

Shoqëria mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera që kanë qëllim ose që kanë lidhje me objektin e saj, ajo mund të bëjë të gjithë ato veprime që i duken të arsyeshme për zhvillimin e aktivitetit të saj.

## KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

### NENI 4

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

## KAPITALI I SHOQËRISË

### NENI 5

Kapitali filletar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**Euro Job**” Sh.p.k, do të jetë 100.000 Lek, dhe përfaqësohet nga kontributi i anëtarit të vetëm themelues, i ndarë në një kuotë.

Kapitali filletar mund të shtohet osë të pakësohet sipas vendimit të ortakut themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

### NENI 6

Ortaku i vetëm duhet të bëje përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjera dhe të shoqërisë.

## DREJTIMI I SHOQËRISË

### NENI 7

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, ortaku themelues i shoqërisë **Z.Elvis Sherifi**. i datëlindjes 04.11.2001, lindur në Bërzhitë dhe banues në Ibë e Poshtme, Bërzhitë, Tiranë, banese private, me afat 5 (Pesë) vjeçar.

### NENI 8

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut themelues të shoqërisë.

## **NENI 9**

Shoqëria do të rregullojë veprimtarinë e saj me Statutin e saj, i cili pasi të nënshkruhet nga Ortaku i vetëm do të fitojë personalitet juridik në ditën e regjistrimit në Qendrën Kombetare të Biznesit Tiranë.

## **NENI 10**

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykojnë dhe zgjidhen në zbatim të legjisacionit shqiptar.

## **NENI 11**

Shoqëria ka vulen e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrithin e saj.

## **NENI 12**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje në legjisacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, mbi krijimin e shoqërive tregtare.

## **NENI 13**

Ky akt themelimi (kontratë) do të hyjë në fuqi pas regjistrimit të shoqërisë në Q.K.B Tiranë.

## **NENI 14**

Akti i themelimit, u përpilua në 3 kopje, ku një kopje do të depozitohet në Q.K.B Tiranë, dy kopje do të mbeten në dokumentacionin bazë të shoqërisë tregtare private “**Euro Job**” Sh.p.k.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

### **ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË**

**“Euro Job” Sh.p.k**

**Elvis Sherifi**

*Elvis Sherifi*

